

Minutat e takimit:

Ditën e martë, datë 16.06.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për projektligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Kimikateve”.

Në këtë takim merrnin pjesë:

Znj. Eralda Hoxhaj, Instituti per Menaxhimin e Territorit dhe Mjedisit;
Z. Gezim Shehu, shoqeria civile;
Z. Erlind Muho, shoqeria civile;
Z. Daniel Sheti, Asistent Kimist-MM;
Z. Endri Haxhiraj, Instituti i Politikave Mjedisore;
Znj. Vanela Haxhiraj, Instituti i Politikave Mjedisore;
Z. Klodian Aliu, EU Delegation, Expert;
Znj. Alba Thoma, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Transparencës së Komunikimit, Ministria e Mjedisit;
Znj. Laureta Dibra, Përgjegjëse e Sektorit të Ajrit, Ndryshimeve Klimatike dhe Kimikateve;
Znj. Rovena Agalliu, specialiste, Sektorit të Ajrit, Ndryshimeve Klimatike dhe Kimikateve;
Znj. Jonila Haxhillari, Specialiste e Sektorit të Ajrit, Ndryshimeve Klimatike dhe Kimikateve;

Dëgjesa u hap nga znj. Laureta Dibra, Përgjegjëse e Sektorit të Ajrit, Kimikateve dhe Ndryshimeve Klimatike, e cila vijoi me një prezantim të detajuar për përmbajtjen e projekt-aktit, duke u përqendruar në risitë që sjell ky projektligj, skemën e ngritur në nivel evropian për menaxhimin e integruar të kimikateve si dhe përshtatjen e tyre në nivel kombëtar etj.

Projektligji është një projektakt horizontal që përcakton rregullat **ndaj prodhuesve, importuesve, përdoruesve profesional dhe aktoreve të tjere në zinxhirin e furnizimit të kimikateve, përpara vendosjes** së një kimikati **ne treg**, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, sa lidhet me:

1. klasifikimin, etiketimin, paketimin dhe dokumentacionin me të dhenat e sigurisë;
2. kufizimet në prodhim, vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave me rrezikshmeri të lartë

Projektligji funksionon paralelisht me legjislacionin tjetër specifik që mbulon **ceshtjet e sigurisë së kimikateve që lidhen me përdorimin e tyre**.

Përparësitë e këtij projektligji lidhen me përparësitë që kanë rregulloret në fuqi të BE-së, të cilat ky projektakt i transponon (REACH dhe CLP), në krahasim me legjislacionin e shfuqizuar të BE-se.

Në krahasim me legjislacionin ekzistues ku përgjegjësitë kryesore për menaxhimin e kimikateve gjatë gjithë ciklit të jetes së tyre binin kryesisht mbi autoritetet kompetente, sipas projektligjit të ri përgjegjësitë kryesore lidhur me regjistrimin, klasifikimin, etiketimin, paketimin, vlerësimin e sigurisë së kimikateve, dokumentin me të dhenat e sigurisë së kimikateve etj, bien mbi prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit të tjerë në zinxhirin e furnizimit të kimikateve.

Sipas këtij projektligji synohet të krijohet një sistem i menaxhimit të kimikateve në linjë me ato të BE-se ku autoriteti kompetent si dhe prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit në zinxhirin e furnizimit të kimikateve, të përgatisin veten e tyre, për të kryer të njëjtat detyra me ato që do të

kryejne kur te jemi vend anetar i BE-se.

Takimi vijoi me pyetje dhe diskutime për regjistrimin dhe kufizimet e kimikateve si dhe rolin e institucioneve të ndryshme në menaxhimin e kimikateve etj.

Cdo koment tjetër a sugjerim për përmbajtjen e projektaktit, është i mirëpritur në adresën elektronike zyrtare të Ministrisë së Mjedisit që është info@moe.gov.al